

TERMAT E REFERENCËS

Konsulent/ Expert Lokal

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, realizon shqyrtime analitike mbi përmbajtjet e emetuar nga OSHMA-të, në vlerësim të përputhshmërisë së tyre me kushtet e licencës/autorizimit dhe Kodit të Transmetimit të AMA-s. Këto shqyrtime lidhen me problematikën më të mprehtë të tregut audioviziv, si mbrojtja e të miturve, komunikimet tregtare dhe reklamat, hapësira për personat me aftësi të kufizuara, përdorimi i shqipes së standardizuar etj.

Një nga formatet më të aplikuara në emetimet televizive janë dhe debatet a forumet mbi tema të aktualitetit dhe që kanë rendësi për publikun. Për vetë impaktin që kanë këto programe tek shikuesit si dhe problematika që haset gjatë zhvillimit të tyre në aspektin e zbatimit të Kodit të Transmetimit (etika e komunikimit, privatësia, gjuha e urrejtjes, prezumimi i pafajësisë, e drejta e përgjigjes për palët e cënuara etj.,) si dhe për vlerësimin se sa përmbajtje të tilla ndikojnë krijimin e kulturës publike – AMA kërkon një studim tregu, me fokus programet kryesore debatuese / forum, si psh Opinion (Klan), Top Story dhe Top Show (Top Channel), Studio e Hapur (News 24), Dritare dhe Kapital, (Vizion Plus) Tonight Ilva Tare dhe Të paeksponuarit (Ora News).

Për realizimin e këtij studimi tregu eksperti duhet:

Objektivi

Të ndjekë dhe të ofrojë një ekspertizë profesionale mbi emisionet e formatit debatues / forum duke arritur në një analizë të detajizuar të problematikës që vihet re, si dhe për vlerësimin që këto përmbajtje kanë në krijimin e kulturës publike.

Detyrat

Eksperti do të punojë në sinkroni me Autoritetin e Mediave Audiovizive, për realizimin e detyrave të mëposhtme:

- Përpilon një program të detajizuar pune mbi studimin, të ndarë në fazat e realizimit të tij dhe produktet përbërës.
- Monitoron dhe vlerëson cilësinë e përmbajtjeve që janë target, sipas një kuadri problematik që është më evident.
- Realizon një relacion të detajizuar duke renditur dukuri dhe aspekte të përbashkëta dhe të veçanta për secilin nga formatet që janë target për studimin, si dhe përfundimet e rekomandimet përkatëse.

Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë Ekspertit të gjithë informacionin / dokumentet e nevojshme për t'u njohur nga eksperti me qëllim përmbushjen e këtyre detyrave.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët. Periudha e zbatimit të kontratës do të jetë deri më datë 31 Dhjetor 2016.

Në rast nevojë, dhe me kërkuesin e arsyetuar me shkrim të parashtruar nga eksperti, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë periudhën e zbatimit të kontratës. Cdo zgjatje e kontratës do të jetë subjekt i performancës së mirë nga ana e Ekspertit. Kjo do të gjykohej, në vecanti në drejtim të progresit drejt arritjes së qëllimit të shërbimit.

Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertëve:

- Eksperiencë të gjatë në angazhimet në fushën e medias;
- Eksperienca e mëparshme në kërkime shkencore akademike dhe publikimi ose hartimi i politikave do të jetë avantazh;
- Përvojë dhe pjesëmarrje në shërbime të tjera të ngjashme;
- Aftësi organizuese; planifikim dhe përmbushje e afateve;

Produktet dhe materialet

Eksperti do të paraqesë në gjuhën shqipe studimin e thelluar në versionin e plotë, ku do të përfshihen dhe të gjitha propozimet e rekomandimet përkatëse.

Raportimi

Eksperti do të mbajë komunikim të ngushtë me Drejtorinë e Programeve.